

BULETINI MUJOR

*Ministër Shteti për Mbrojtjen e
Sipërmarrjes*

VIZITAT NË EKOSISTEM



DigitSapiens është një kompani shqiptare që ofron shërbimet teknologjike më të avancuara për institucionet më të mëdha logjistike në botë, e përbërë nga 52 punonjës, mosha mesatare e të cilëve është 25 vjeç. Dritoni bashkë me Arjolin, themeluesit, na prezantuan me një nga projektet e Digit Sapiens: CargoFlags, platforma e njohur ndërkombëtarisht në fushën e logjistikës, ofron shërbime digjitale për shpërndarjen e mallrave dhe gjetjen e automjeteve.



Inteligjenca artificiale vazhdon të rritet me hapa të shpejtë në Shqipëri. Arbi dhe Ledio, dy të rinj të apasionuar pas zgjidhjeve inovative, më prezantuan me kompaninë e tyre të re, SKAITECH të krijuar rishtazi e cila operon në fushën e droneve, në robotikë, siguri dhe IoT.



Kënaqësi të vizitoja "M.&M. Ivanaj Foundation Institut", ku na mirëpriti znj.Drita Ivanaj, drejtuese e fondacionit. Brenda Institutit është krijuar Qendra e Inkubacionit të Biznesit dhe Inovacionit (BIIH), i cili ofron një sërë shërbimesh në mbështetje të sipërmarrësve të rinj. Për të gjithë startupet në fazë ideje, Ivanaj Foundation është një pikë referimi në ekosistem.

PROJEKT-LIGJI "PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE"

Në datën 3 Shkurt, ishte seanca e parë e prezantimit të "Ligjit për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve" në Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Vazhduam me miratimin në dy komisione: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese dhe Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Tejet e kënaqur që për këtë projektligj edhe opozita është dakord dhe e votoi në parim 'pro'. Ky nuk është ligji jonë, është ligji i të rinjve që dëshirojnë të ndryshojnë botën dhe punojnë çdo ditë në këtë drejtim.






TAKIMET ME PËRFAQËSITË E HUAJA

Mirëprita në takim përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Enzo Damiani, Officer i Programit për sektorin e Tregut të Brendshëm, Inovacionit dhe Konkurrueshmërisë, si dhe Andrea Vera-n, Drejtor për Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe Social. Diskutuam për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të projektligjit të startup-eve, si edhe mbi temën e inovacionit në vendin tonë.

Mbështetja dhe zhvillimi i sipërmarrjes, si dhe forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve të biznesit mes Shqipërisë dhe Francës, ishin në fokus të bisedës me Ambasadorën e Francës në vendin tonë, SH.S.Zj. Elisabeth Barsacq. Kemi jo pak raste suksesi kompanish franceze që kanë investuar në Shqipëri, ashtu sikurse ka një sërë programesh që u vijnë në ndihmë sipërmarrjeve që do t'i prezantojmë në vijim.



Investimet e huaja kanë një rëndësi thelbësore për ekonominë tonë. Pata kënaqësinë të prisja ambasadorin hollandez z. Reinout Vos, ku diskutuam mbi bashkëpunimin jetëgjatë midis dy vendeve, klimën e biznesit për kompanitë hollandeze në Shqipëri, problematikat e deri tek startupet.



U prezantua Albaniatech, databaza e parë e startupeve shqiptare, që do ta ndihmojë të jetë në hartën e ekosistemit evropian të inovacionit. Baza e të dhënave, si dhe ligji për startup-et që presim të miratohet së shpejti, do të jenë mundësi e shkëlqyer për të mbështetur ekosistemin për të qënë konkures ndërkombëtarisht. Me Albaniatech jemi dakordësuar për një marrëveshje bashkëpunimi për të rritur akoma më shumë sinergjinë mes ekosistemit dhe sektorit publik.